



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë*  
*Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine*  
*Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

---

01 Ref. Nr.01/96  
Prishtinë: 29.12.2023

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 11, paragrafit 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10 dhe 11, të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), si dhe shtojca 12 e Rregullores (QRK) - nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

**V E N D I M**

1. Shfuqizohet Rregullorja (MTI) Nr.01/2013 për Kërkesat Teknike për Pllakat e Drurit.

**A r s y e t i m**

Rregullorja Nr. 01/2013 për kërkesat teknike për pllakat e drurit është pjesë e Programit për Eliminimin e Barrierave në Tregti 2021-2025 i miratuar nga Qeveria e Kosovës me Vendimin e dt. 22/16 të dt. 22.06.2021,dhe është shqyrtuar se a përmban barriera në tregti apo masa me efekt ekuivalent që i cenon parimet e nenit 34-36 të TFBE. Nga shqyrtimi ka rezultuar që rregullorja është një akt kombëtar që nuk tranzponon legjislacion të BE-së dhe përmban “Masa me efekt ekuivalent” që e pengojnë tregtinë e lirë. Kjo konfirmohet edhe nga referenca në standarde kosovare të cilat janë të listuara në Aneksin 2 të Rregullores.

Për vlerësimin e konformitetit duhet të zgjidhet procedura më pak e vështirë e që mund të kënaq nivelin e lartë të mbrojtjes së interesit publik. Testimi dhe certifikimi i palëve të treta për të gjitha karakteristikat nuk është proporcional.

Në bazë të asaj që u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare.

**Rozeta HAJDARI**

---

**Ministre**

Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministres;*
- *Zyra e Sekretarit të Përgjithshme;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Arkivit të MINT.*